



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

SHBALLJE PËR POZICIONIN SPECIALIST

Në zbatim të Vendimin Nr. 132, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”, si dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr. 94, datë 12.06.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”.

2 (dy) Specialistë të Sektorit të Planifikimit, në Drejtorinë e Planifikimit, Koordinimit dhe Fizibilitetit, në Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve

Afati për dorëzimin e dokumenteve 28/06/2024 pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Kontribon në planifikimin e nevojave lidhur me menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe identifikimin e proceseve dhe masave për kalimin drejt ekonomisë qarkulluese.
- Kontribon në planifikimin e prioriteteve në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve në përputhje me programin dhe strategjitë e zhvillimit të mjedisit, si dhe strategjinë sektoriale të mbetjeve.
- Kordinon me bashkitë për planifikimin e infrastrukturës së nevojshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve, në linjë me detyrimet e integritit evropian të vendit dhe EU ‘Acquis’ të fushës së mbetjeve Ndjek dhe zbaton objektivat dhe detyrat e caktuara në fushën e planifikimit në bashkëpunim me specialistët e tjerë të sektorit;
- Kontribon në veprimtarinë e Sektorit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me funksionet e objektivat e Drejtorisë për çështje që lidhen me planifikimin në fushën e mbetjeve.
- Përgatit raporte vlerësuese, opinione dhe mendim teknik për çështjet e planifikimit në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe zbatimit të hierarkisë së mbetjeve.

KUSHTET PËR PRANIM DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për pranim si dhe kriteret e veçanta si vijon:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojnë diplomë të ciklit të dytë të studimeve, të nivelit “Master Shkencor”/ “Master Profesional”, në shkenca Shoqërore/Juridike/Mjedisore.

- d. Të kenë të pakten 1 (një) vit eksperiencë pune;
- e. Të mos jetë marrë ndaj tij masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- f. Të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- g. Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës;

- h. Të ketë njohuri shumë të mira profesionale të çështjeve teknike dhe detyrave që do të kryejë
- i. Të ketë aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritete dhe respektuar afatet;
- j. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi;
- k. Të ketë aftësi analitike në zbatimin e detyrave;
- l. Të kenë aftësi të mira për zhvillimin e punës në grup;
- m. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- n. Të ketë aftësi në formulimin e objektivave, vendosjen e prioriteteve dhe respektimin e afateve;
- o. Të ketë aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të reja.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
 - b- Fotokopje të diplomës/diplomave dhe listes së notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
 - c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (në momentin e fillimit të marrëdhënieve të punës);
 - f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
 - g. Dy referenca nga punëdhënës apo bashkëpunëtorë të mëparshëm;
 - gj. Çertifikata për trajnime në lidhje me pozicionin për të cilin konkurojnë;
 - h- Vërtetim nga institucioni që nuk ka mase disiplinore në vitin e fundit;
 - i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Dokumentat duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në MTM brenda datës 28/06/2024.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT TË DOKUMENTACIONIT

Komisioni Ad-Hoc do të shpallë në faqen zyrtare të MTM-së www.turizmi.gov.al, tek kategoria/menuja “Njoftimet”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për intervistën e strukturuar me gojë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të intervistohen për njohuritë mbi dokumentet e listuara më poshtë:

-Njohuritë mbi Ligjin nr. 10431, datë 9.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar;

-Njohuritë mbi Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i ndryshuar;

-Njohuri mbi VKM-në nr. 418, datë 27.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035”;

-Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë";

-Njohuritë mbi Ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;

-Njohuri mbi Vendimin Nr. 132, datë 6.03.2024, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen edhe në lidhje me:

a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me organizimin dhe drejtimin e veprimtarisë drejtuese;

b- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE KOMUNIKIMI

Kandidatët do të vlerësohen me pikë si më poshtë:

a- Intervistën e strukturuar me gojë, deri në 60 pikë;

b- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 40 pikë.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore në MTM do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe do të shpallë fituesit në faqen zyrtare të ministrisë.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentacioneve të cituara më sipër, duhet të bëhet brenda datës 28.06.2024 në protokollin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;

Zhvillimi i intervistës do të zhvillohet në datën 8.07.2024, në ambientet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;